



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.504/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.07.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Murati D” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-06584-03-29-2017, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 1.264.818 lekë, zhvilluar më datë 02.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.

Ankimues: “Murati D” shpk
Rr e Kavajës, ish Kombinati Ushqimor, godina 1 katëshe,
Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Berat
Lagjia “Iliria”, Berat.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.04.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-06584-03-29-2017, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 1.264.818 lekë, zhvilluar më datë 02.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.

II.2. Në datën 02.05.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 04.05.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Dimex	nuk ka paraqitur ofertë	
- Murati D	901.166 lekë	I kualifikuar
- Euro Mega 2010	999.000 lekë	I skualifikuar

- MB Kurti	1.254.500 lekë	I kualifikuar
- Atlantik 3	1.259.300 lekë	I skualifikuar

II.4. Në datën 15.05.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Dimex	nuk ka paraqitur ofertë	
- Murati D	901.166 lekë	I skualifikuar
- Euro Mega 2010	999.000 lekë	I skualifikuar
- MB Kurti	1.254.500 lekë	I kualifikuar
- Atlantik 3	1.259.300 lekë	I skualifikuar

II.4. Në datën 15.05.2017 operatori ekonomik “Murati D” shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

“Bilancet nuk janë tëi shoqëruara me raport auditimi nga ekspert kontabël i miratuar, si kriter i kërkuar nga AK”.

II.4.1. Në datën 19.05.2017 operatori ekonomik “Murati D” shpk., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Konkretisht ankimesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

“Duke u mbështet në LPP për tenderimin elektronik, shikojmë se oferta sone i është bërë një përjashtim i padrejtë dhe në kundërshtim me këtë ligje.

KVO ka bërë dy vlerësime të OE një me datë 04/ 05/ 17 ku oferta jone vlerësohet e para nga oferta sipas vlerësimit të ofertave. Por gjithçka kur në pritshmëri që AK të dërgonte njoftimin në APP shikojmë pas 11 ditësh në sistem një rivlerësim tjetër ku oferta jone skualifikohet dhe kualifikimi mbeti në ofertën me çmimin më të lartë ose e thënë ndryshe me një diferencë mbi 300.000 leke të reja në krahasim me ofertën tonë. E shprehur në përqindje 27% me të lartë se oferta jone, KVO pretendon se oferta jone skualifikohet se: “nuk kemi paraqitur raport auditimin nga ekspert kontabel i bilanceve”. Ky fakt me datën 04/ 05/ 17 u anashkalua sepse shoqëria jone nuk i plotësoi kushtet e ligjit për të kryer raport auditimi nga Ekspert kontabel të bilanceve, por tani me datë 15/ 05/ 17 vendosi skualifikimin e ofertës sone me këtë protekst .

Sqarojmë se ligji përkatës me nr 10098 datë 05.03.2009, i ndryshuar me ligjin 47/2016 dt 28.04.16 për auditin ligjor të organit të ekspert kontabel, përcakton se duhet që 2(dy) nga tre kushtet të plotësohen dhe pastaj të kryhet raporti ekspertizë të bilanceve përkatëse. Sqarojmë kushtet: 1-totali i aktivitetit mbi 50 milion leke, ku në kemi atë me 32 milion leke. 2-Numri i të punësuarve mbi 30 punonjës kur në kemi aktualisht 7(shtatë)punonjës. Të ardhurat mbi 100 milion leke. Si shikohet nga dokumentacioni i paraqitur në tender shoqëria jone jo dy por asnjë kusht nuk plotëson që të kryej raport auditimin nga ekspert kontabel të bilanceve.

Prandaj KVO ka shkelur ligjen e vleresimit te ofertave, duke paraqitur nje kriter qe ne nuk plotesojme kushtet per te kryer ekspertizen e bilanceve. Nisur nga k yfat kerkojme qe vleresimi te behet sic u be me date 04.05.2017. KVO beri dy vleresime me te njejta kriteret . E perseris sipas ligjit nr10098 shoqeria jone nuk detyrohet te kryej kete raport auditimi. Prandaj duke u nisur nga keto te gjitha kerkojme kualifikimin e ofertes sone.”.

II.5. Në datën 21.05.2017, me shkresën nr. 2388/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Murati D” shpk është vënë në dijeni në lidhje refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 29.05.2017 operatori ekonomik ankimues “Murati D” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.2594/1 prot, datë 02.06.2017 protokolluar me tonën me numër 1015/2, datë 05.06.2017 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Murati D” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Bilanci 2014, 2015, 2016 nuk është i shoqëruar me raport auditimi nga ekspert kontabël i licencuar*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën 7 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” pika 2.2 “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, nënpika 2.2.1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

”2.2.1 *Bilanc i vitit 2014, 2015, 2016 i konfirmuar nga autoritetet perkatese (organi tatimor) dhe te shoqeruar me raport auditimi nga ekspert kontabel i licensuar*”.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Murati D” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Pasqyrat Financiare për Vitin 2016 të certifikuara nga organet tatimore;*
- *Pasqyrat Financiare për Vitin 2015 të certifikuara nga organet tatimore;*
- *Pasqyrat Financiare për Vitin 2014 të certifikuara nga organet tatimore.*

III.1.3. Në ligjin 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” neni 41 të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. [...]”

III.1.5. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Sa më sipër Komisioni konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin bilancet e viteve 2014, 2015, 2016 të konfirmuara nga autoritetet perkatese (organi tatimor) dhe të shoqëruar me raport auditimi nga ekspert kontabel i licensuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi Komisioni konstaton se janë dorëzuar pasqyrat financiare për vitet 2014, 2015, 2016 të certifikuara nga organet tatimore, të pashoqëruara me Raportin e Audituesit të Pavarur.

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe shqyrtimit të pasqyrave financiare të ankimuesit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, rezulton se ankimuesi nuk i nënshtrohet procesit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese, duke qenë se pikë së pari, nuk përmbush vlerën që parashikon ligji për auditimin e pasqyrave financiare për këto vite, për totalin e aktiveve të bilancit. Akoma më tej Komisioni pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, lidhur me mosplotësimin e kushteve kumulative që ligji parashikon për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, konstaton se shoqëria "Murati D" shpk, referuar vërtetimit nr.16379/1 datë 05.04.2017 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesit të Mëdhenj ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/ shërbimeve nën vlerën që parashikon ligji për auditimin e pasqyrave financiare, si më poshtë:

- për vitin 2014, shumën prej 34.587.624 lekë;
- për vitin 2015, shumën prej 36.945.250 lekë;
- për vitin 2016, shumën prej 32.968.881 lekë.

Gjithashtu referuar vërtetimit Nr.2332/1 Prot, datë 27.01.2017 dhe vërtetimit 16379/2, datë 05.04.2017 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesit të Mëdhenj, rezulton se shoqëria "Murati D" shpk, ka fuqi mesatare të punonjësve prej 6, 3 punonjësish për vitin 2016 dhe 2 punonjësish për periudhën janar-shkurt 2017.

Pra duke qenë se nuk plotësohen dy nga treguesit e vendosur nga legjislacioni në fuqi, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore për vitet 2014, 2015 dhe 2016, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese; Komisioni gjykon se mosdorëzimi i raportit të auditimit të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit nga operatori ekonomik "Murati D" shpk, nuk përbën shkak për skualifikimin e tij.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Murati D" shpk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-06584-03-29-2017, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 1.264.818 lekë, zhvilluar më datë 02.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Murati D” shpk duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomike “Murati D” shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1015 Protokoli, Datë 29.05.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha